



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 10/11 Prot.

Tiranë, më 03/05 2011

Lënda: Rekomandim për **“DNA & GREY” sh.p.k.**

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **“DNA & GREY” sh.p.k.**

KONSTATOVA

Më datë 02.03.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“DNA & GREY” sh.p.k.**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, parashikuar në nenet 8,9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* .

Komisioneri *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi **“DNA&GREY” sh.p.k** është kompani e specializuar për zhvillimin e programeve sociale dhe edukative, është përfaqësues në Shqipëri i Procter &Gamble

Marketing Romania SRL. Ka kryer regjistrimin e veprimtarisë së tij pranë organeve me nr. Nipt K72414006N dhe është në fazën përgatitore të aktivitetit të tij.

Ky kontrollues ka hartuar programe për nënën dhe fëmijën, duke kryer përhapjen e materialeve edukative dhe informative që kanë të bëjnë me nevojat e të porsalindurve, përkujdesjes ndaj tyre, gjendjen e nënës pas lindjes etj.

Në kuadrin e veprimtarisë së tij kontrolluesi “DNA &GREY” sh.p.k, për efekt të implementimit të Programit “Pampers” në Spitalet Rajonale të gjithë Shqipërisë, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për nënat e reja, fëmijët e porsalindur, infermiere, mjeke me qëllim edukimin e nënave të reja në rritjen e fëmijës, si dhe bërjen e promocioneve për produktet e *Procter & Gamble*.

Kontrolluesi ka hartuar një formular nëpërmjet të cilit mbledh të dhëna personale duke ia ofruar për plotësim kategorive të mësipërme, së bashku me pakon e produkteve *Procter & Gamble* “Zbulo botën time”.

Formulari që përdoret për mbledhjen e të dhënave personale është konceptuar prej kontrolluesit “DNA &GREY” sh.p.k, në dy pjesë, **në pjesën e parë** të tij sqarohet fillimisht se ...” *Plotësimi i këtij formulari nuk është detyrues dhe as nuk është urdhëruar për marrjen e pakos “zbulo botën time”, më pas vjen rubrika e mbledhjes së të dhënave personale të kërkuara prej subjekteve të të dhënave, është formuluar marrja e pëlqimit dhe refuzimi i tij, referuar ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe rubrika e nënshkrimit të subjektit të të dhënave personale (nënës se fëmijës) dhe infermieres.*

Në pjesën e dytë të formularit në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi jep një informacion të hollësishëm mbi përdorimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, mënyrën e përpunimit, transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt shtetit të Rumanisë dhe shteteve të tjera anëtare të BE-së, qëllimin e përdorimit dhe theksohet fakti që plotësimi i këtij formulari është vullnetar.

Formulari që kontrolluesi “DNA &GREY” sh.p.k përdor për mbledhjen e të dhënave personale nga subjektet e të dhënave, i ndërtuar në këtë formë nuk i krijon mundësinë subjektit të të dhënave personale që fillimisht të informohet, pasi informimi është vendosur në pjesën e dytë të formularit (në pjesën e pasme), ndërkohë që në pjesën e parë të formularit mbledhen të dhënat personale dhe kërkohet nënshkrimi nga ana e subjektit.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 germa b) i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ”.... Mbrojtja e të dhënave personale bazohet,.....në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dher në përpunimin në përputhje me këto qëllime”.

Gjithashtu, kontrolluesi "DNA & GREY" sh.p.k ka deklaruar se, në ushtrim të aktivitetit të tij do të kryejë transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, pranë shoqërisë qendrore *Procter & Gamble Marketing Romania SRL*, në shtetin e Rumanisë.

Kontrolluesi "DNA & GREY" sh.p.k bën informimin e subjekteve të të dhënave personale, lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale duke e shprehur këtë në formularin që përdoret për mbledhjen e të dhënave personale.

Kontrolluesi "DNA & GREY" sh.p.k ka filluar ushtrimin e aktivitetit të tij për zhvillimin e programit të vecantë kushtuar nënës dhe fëmijës "zbulohet time", i cili ka për qëllim mbështetjen e imunizimit dhe edukimit për kujdesin e fëmijës, program i cili mbështetet nga kompania *Procter & Gamble Marketing Romania SRL*, nëpërmjet markës "Pampers". Ky kontrollues ka filluar të bëjë transferim ndërkombëtar të të dhënave personale të subjekteve, duke marrë masat e duhura ligjore, lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale si (deklarimi në formular-njoftimi pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për transferimin e të dhënave personale në një shtet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale si dhe informimin e subjekteve të të dhënave personale lidhur me transferimin ndërkombëtar të tyre).

Kontrolluesi për implementimin e këtij projekti ka hartuar një protokoll bashkëpunimi me spitalet gjinekologjike (maternitetet) në Shqipëri në të cilën janë përcaktuar kritere dhe detyrime të secilës palë lidhur me zbatimin e këtij projekti, por konstatohet se, në protokollin e bashkëpunimit (*i cili është realizuar në formën standarde tip për të gjithë spitalet që marrin pjesë në këtë program*) nuk ka të shprehur dhe të shkruara rregulla të qarta lidhur me konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave dhe përgjegjësitë e palëve në rast të përdorimit të të dhënave për qëllime të tjera.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27/2 "c" i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", ".....Udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave ". dhe neni 28 i ligjit, "*Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit*".

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27/2, gërma "c" dhe 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", kontrolluesi "DNA & GREY" sh.p.k, në protokollin e bashkëpunimit me spitalet gjinekologjike (maternitetet) në Shqipëri, të përcaktojë detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve lidhur me konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale që mblidhen dhe përpunohen gjatë zbatimit të programit "zbulo botën time", i cili konsiston në shpërndarjen e materialeve sanitaro – edukative, tek nënat e reja të cilat lindin në maternitetet.
2. Në zbatim të nenit 5, pika b) të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", kontrolluesi "DNA & GREY" sh.p.k, duhet të kryejë konceptimin në një formë të re të formularit që përdor për mbledhjen e të dhënave personale, në të cilin pjesa informuese për subjektin e të dhënave personale të vendoset përpara pjesës ku shprehet pëlqimi dhe nënshkrimi nga ana e subjektit të të dhënave personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

